



KAYO SH.A

No. 333 Prot

Tiranë, më 06/08/2025

VENDIMI I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË AKSIONARIT

NR. 4, DATË 6/08/2025

PËR NDRYSHIMIN E KAPITALIT

Në mbështetje të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët Dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, Ligjit Nr. 88/2024 "Për krijimin e shoqërisë shtetërore për prodhimin dhe tregtimin e armëve, municioneve, pajisjeve dhe teknologjive ushtarake", si edhe në bazë të Nenit 7 (1), neni 10, pika dh) të Statutit të Shoqërisë, në përfundim të mbledhjes, Asambleja e Ortakëve,

VENDOSI :

1. Rritjen e kapitalit fillestar të shoqërisë KAYO sh.a, për vlerën 150,000,000 Leke, pa ndryshuar numrin e aksioneve
2. Si rezultat, kapitali i ri i shoqërisë do të jetë në vlerën 300,000,000 Lekë.
3. Shtimi i kapitalit do të realizohet nëpërmjet kontributeve në të holla nga aksionari ekzistues i cili do të transferojë shumën përkatëse në llogarinë bankare të shoqërisë.
4. Numri i aksioneve mbetet i pandryshuar, ashtu si edhe përqindja e pronësisë në shoqëri.
5. Administratori i shoqërisë ngarkohet të pasqyrojë shtimin e kapitalit në statutin e shoqërisë, të përgatisë dokumentacionin përkatës dhe të bëjë aplikimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) për regjistrimin e ndryshimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

PËR AKSIONARIN E VETËM MINISTRIA E MBROJTJES

MINISTRI

Pirro VENGU

